

Komunat kërkojnë pavarësi financiare

Krerët komunalë kërkojnë që përmes ndryshimit të Ligjit mbi financa lokale të lirohen nga ndërhyrjet e nivelit qendror, sipas të cilëve po ngufasin autonominë e tyre të përditshme mbi vendimmarrjet financiare

Besiana Xharr

PRISHTINË → Udhëheqësit e komunave të Kosovës, nga të gjitha partitë, përfshirë edhe të asaj në pushtet kërkojnë që të kenë autonomi financiare. Ata ankohen se kanë ndërhyrje nga niveli qendror kur janë në ndarjet buxhetore dhe shpenzimi i tyre. Edhe pse me Kushtetutën e Republikës së Kosovës sqarohet saktë se Kosova duhet të veprojë si nënshkruese e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, që do të thotë autonomi komunale mbi vendimmarrjet financiare dhe strukturat e stafit, kjo nuk zbatohet sipas kryetarëve të komunave. Krerët komunalë thonë se nuk kanë autonomi për të vendosur mbi strukturën e tyre buxhetore, bëjnë investime kapitale por nuk iu lejohehet shtesë për operim e mirëmbajtje, kanë probleme me tenderimin e projekteve për shkak rrugullave të komplikuar, nëse nganjëherë kanë në dispozicion përdorimin e buxhetit

përbëhet bazë lotarisë dhe zgjedhën katër kryetarë, me kriteret të Ministrisë së Financave, tha Ibrahim. Kërkesa tjetër e AKK-së është që investimet kapitale prej nivelit qendror nëpër komuna, të shpërdahen në mënyrë më të drejtë, ku një prej kushteve është që ato të realizohen duke u paraprirë nga studimet e fizibilitetit, për të marrë për bazë nevojat e komunave dhe kost-benefitin e tyre. Rreth zbritjes së grantit qeveritar, Ramadan Avdiu, zëvendësministër i Financave tha se, “me këtë komunat do të stimulohen për të ngritur të hyrat vetjake, pastaj komunat do t’i shpenzonin të hyrat vetjake, sepse ka raste siç është me Prishtinën, e cila disa herë nuk i ka shpenzuar ato. Kurse arsyeja tjetër është edhe regjistrimi i popullsisë”. Sa i përket komisionit për ndarjen e granteve, Avdiu thotë se nëse kërkesa e AKK-së, që në komision të jenë anëtarët e bordit të tyre, miratohet, është e mirëseardhur edhe

për Qeverinë. Por, të gjitha këto deklarata të tij, hedhen poshtë nga udhëheqësit e AKK-së, përfshirë edhe bashkëpartiaqët e tij që udhëheqin me komunat e Kosovës. “Nuk është në rregull të sanksionosh të gjitha komunat, pse njëra prej tyre nuk ka shpenzuar të hyrat vetjake, në këtë rast nuk dihet edhe nëse Prishtina ka pasur arsyet e veta pse nuk i ka shpenzuar ato, tha ai. “Kurse preteksti se kjo bëhet për t’i stimuluar komunat nuk qëndron, sepse komunat e kanë bërë një gjë të tillë, ato vitin 2012 kanë ngritur të hyrat për 12.16 për qind në krahasim me vitin 2011, por çështja është se komunat nuk i kanë gjithmonë të sigurtat të hyrat vetjake siç i ka niveli qendror”, tha Ibrahim. Ndërkaq, për regjistrimin e popullsisë, Ibrahim tha: “Kjo është sikur tani të thuhet se për këtë arsye tani Kosova ka nevojë për më pak policë ose numra të telefonit”. Ulja e grantit nuk

të ndodhë, thotë në anën tjetër, Pal Lekaj, kryetar i Gjakovës dhe anëtar i Bordit të AKK-së. “Kjo për shkak se komunat nuk kanë të hyra vetjake të mëdha që të mund t’i kryejnë shërbimet që i kanë”, tha ai. Qemaj Mustafa, kryetar i Gjilanit, i cili vie nga partia në pushtet, PDK, e demanton bashkëpartiaqun e tij Avdiu, dhe thotë se kjo Qeveri nuk i ka ndarë investimet kapitale në bazë të nevojave të komunave. “Para disa dite jemi takuar këshilli i kryetarëve të komunave dhe të gjithë jemi pajtuar për këto tri pika, që fillimisht të mos ketë ulje të granteve, investimet kapitale të bëhen bazë nevojave të komunave dhe në komisionin për ndarjen e granteve të jetë i pranishëm bordi i AKK-së”, tha Mustafa. Ndryshe, sipas zyrtarëve të AKK-së, ata kanë marr edhe përkrahjen e donatorëve të ndryshëm për ndryshimin e ligjit në fjalë, i cili li së shpejti pritet të kalojë në Qeveri për miratim dhe më pas në Kuvend të Kosovës.